

**Ma. Ilirjana KACELI**

## **KRYENGRITJA E SHQIPËRISË SË MESME DHE ROLI I TURQVE TË RINJ**

Me propozimin e Austro-Hungarisë e të Italisë dhe me miratimin e të gjitha Fuqive të Mëdha një vit pas Shpalljes së Pavarësisë u vendos si princ i Shqipërisë Vilhelm Vidi. Menjëherë pas zgjedhjes së Princit u vendos që Durrësi të bëhej kryeqendër e qeverisë së Vidit. Këtë rrethanë e shfrytëzoi Esat Pasha i cili u përpoq që të bëhej figura kryesore pas princit, sidomos me largimin nga qeverisja të rivalit të tij më të madh Ismail Qemalit.

Princ Vidi mbërriti në Shqipëri më 7 mars 1914. Menjëherë sapo mbërriti në Shqipëri formoi qeverinë me në krye Turhan pashë Përmetin. Ndërsa Esat Pashën e caktoi ministër të Brendshëm. Qeverisja e tij qysh në fillim nuk u pëlqye nga shqiptarët nga që këshilltarët kryesorë të tij nuk ishin shtetas shqiptar<sup>1</sup>.

Duke qenë princ i zgjedhur me marrëveshje, ai do të mblidhte rreth vetes këshilltarë të Fuqive të Mëdha të cilët do të fillonin garimin ndërmjet tyre se kush do të kishte ndikimin më të madh tek princi.

Në qeverisjen e tij do lindin dy rryma, pro-italiane dhe pro-austriake dhe të gjithë anëtarët kabinetit të tij do të ndaheshin në dy kampe. Më 10 prill 1914 do të sanksionohej Statuti organik i Shqipërisë, pra Kushtetuta. Sfida e qeverisjes së princ Vidit ishte ruajtja e kufijve të vendosur nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër.

Vilhelm Vidi gjatë qeverisjes së tij do të ndeshej me vështirësi të mëdha për shkak të njohjes së pakët të gjendjes së ndërlikuar në vend. Pushteti i tij mbështetej vetëm në vullnetin nga jashtë të Fuqive të Mëdha dhe praninë faktike të tyre nëpërmjet anëtarëve të KNK-së.

Pa kaluar as dy muaj nga ardhja në fuqi e princ Vidit u shfaqën mosmarrëveshjet në regjimin e tij. Këto mosmarrëveshje u zhvilluan, midis personaliteteve politike shqiptare si dhe këshilltarëve të huaj, po ashtu edhe ndërmjet administratës dhe vetë shtresave të ndryshme të popullsisë që priste ndryshime të shpejta në vend.

Në këto momente pati ndërthurje kontradiktash të brendshme dhe ndërhyrje politike të Fuqive të Mëdha e të shteteve ballkanike nga jashtë, që çoi në shpërthimin e një kryengritje në vitin 1914-1915. Kjo kryengritje ka hyrë në histori si kryengritja e Shqipërisë së Mesme<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Shblu, Tiranë, 2007, f.60

<sup>2</sup> *Historia e popullit Shqiptar*, vëll. III, Tiranë 2007, f.64

Në të gjithë vendin pati shtrirje territoriale te veprimeve politike e luftarake veçanërisht ndërhyrja e forcave ushtarake greke në të ashtuquajturin Epir të Veriut, që solli probleme të rënda për shtetin e sapo krijuar shqiptar.

Në 17 maj u nënshkrua Protokollin e Korfuzit. Dispozitat e këtij protokollin juridikisht lejonin krijimin e një zone autonome në jug të vendit të cilat sipas shtetit grek banoheshin nga minoritarët<sup>3</sup>.

Kjo ngjarje nuk u prit mirë jo vetëm brenda vendit por edhe jashtë saj. Protesta kundër këtij vendimi i erdhën qeverisë së Princ Vidit edhe nga diaspora shqiptare. Lidhur me këtë, në Amerikë një miting të madh organizoi Federata Panshqiptare "Vatra", e cila nëpërmjet një rezolute shprehu kundërshtimin e vendosur ndaj çdo lëshimi të qeverisë rreth kërkesave të Zografos<sup>4</sup>.

Sipas historiografisë shqiptare, Kryengritja e Shqipërisë së Mesme nga synimet dhe përmasat në të cilat u zhvillua, është e ndarë në dy faza<sup>5</sup>. Kryengritja filloi në Shijak dhe u shtri më pas në qarkun e Durrësit e të Elbasanit. Ajo shpërtheu në datën 17 të muajit maj 1914.

Esad Pashë Toptani si ministër fuqiptotë që ishte në kabinetin e Turhan Pashës në fillim të muajit maj filloi të zhvillonte propagandën e tij<sup>6</sup>. Esadi shfrytëzoi njohuritë jo të plota që kishte Princ Vidi për vendit tonë dhe me pretext se po dërgonte trupa për të luftuar kundër Greqisë shpërndau armë në krahinën e Durrësit, Elbasanit e të Shqipërisë së Mesme. Esad Pasha me anën e agjentëve të tij përhapte urrejtjen dhe mërinë në popull kundër princit dhe ndezte zjarrin për një princ turk nën të cilin fshiheh ai vetë<sup>7</sup>.

Kur në jug barbarizmat e grekëve po zhvilloheshin me tërbim, në Durrës u zbulua se armët e shpërndame prej tij nuk kishin qenë për luftën kundër grekut sepse ky me Baratasin e kish goditur punën por për të armatosur përkrahësit e tij në Shqipërinë e Mesme. Kjo ishte një provë e re që tregonte se ai nuk punonte as për Shqipërinë as për independencën e saj; ai kërkonte sipas marrëveshjes sekrete me serbët një copë tokë në Shqipërinë e Mesme ku vet ai t'ish Princ e Bej<sup>8</sup>.

Kryengritja e Shqipërisë së Mesme, ka ngjallur dhe vazhdon të ngjallë diskutime në historiografinë shqiptare. Duke parë sesi u zhvilluan ngjarjet në këtë rebelim gjykoj që kjo ishte lëvizje antikombëtare.

3 Arben Puto. *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit*. Vëll.II. Tiranë, 1987, f. 614-617

4 Gazeta Dielli, dt.26.5.1914; shih, Beqir Meta. *Federata Panshqiptare "Vatra"*, Globus R, 2001, f.95

5 *Historia e popullit Shqiptar: vëll. III*, Tiranë 2007, f.64

6 Ku shokëve e bashkëpunëtorëve të djeshëm kundra Ismail Qemalit që e pyesnin se qysh e kishim fjalën u përgjigjesh: "Unë prapë n'atë tjalë jam, po pres kohën". T.Selenica. *Shqipëria më 1937*, f.37

7 Teki Selenica. *Shqipëria më 1937*, f.37

8 BOA, D.H. EUM. I.ŞB. Dosya 1 9

Rrjedhja e ngjarjeve të bën të mendosh se këtu kishin dorë fuqitë e huaja të cilët nuk donin të mbronin pavarësinë dhe stabilizimin e jetës politike në Shqipëri. Ata nuk donin ekzistencën e një shteti shqiptar të qeverisur nga vetë shqiptarët. Kjo kryengritje ishte një lojë e shteteve të huaja për të vendosur supermacinë e tyre në Shqipëri dhe për të realizuar ëndrrat e tyre të vjetra. Duke parë ngjarjet si u zhvilluan dhe se si shteti shqiptar shkoi drejt zhdukjes nga loja që luanin shtete të ndryshme duhen theksuar shkaqet që e çuan vendin tonë në këtë situatë.

Shkaqet e këtij rebelimi janë: së pari, politika që turqit e rinj ndoqën në rajon duke akumuluar mllfet dhe mëritë ndaj Fuqive të Mëdha. Drejtuesit unionistë të perandorisë nuk mund të praninin vendimet më të cilat u nënshkrua paqja pas luftërave ballkanike. Në këto marrëveshje, Fuqitë e Mëdha e larguan pothuajse tërësisht Perandorinë Osmane nga rajoni i Ballkanit. Prandaj si Bullgaria ashtu edhe Turqia ishin të pakënaqura nga zgjerimet e Greqisë dhe Serbisë. Ato kishin formuar në mënyrë të fshehtë, një aleancë Bullgaro-Turke e cila nuk u ratifikua dhe mbeti në sirtar. Gjithashtu, të dyja këto vende u bënë aleate me Boshtin qendror në vitet e Luftës së parë Botërore duke u radhitur në koalicion me Gjermaninë dhe Austro-Hungarinë.

Së dyti, intrigat e serbëve, grekëve dhe turqve të rinj, me Esadin e njerëzit e tij ndikuan shumë në një pjesë të popullsisë shqiptare<sup>9</sup>.

Së treti, mënyra e sjelljes së Fuqive të Mëdha ndaj kufijve veriorë dhe jugorë të vendit tonë. Politika që ndiqesh ndaj popullsisë shqiptare veçanërisht nga Austro-Hungaria për ta ngritur atë kundër Serbisë kundërshtares së saj. Rrëzimi i qeverisë së Turhan Pashës, dhe sidomos largimi i Esat Pashës pas marrëveshjes që ai nënshkroi në Nish me Pashiqin kryeministrin e Serbisë, si dhe interesat e tij pro-italiane do ta bëjnë atë të papërshtatshëm për austriakët dhe xhonturqit të cilët i kishte tradhtuar.

Së fundmi Greqia dhe Serbia e kishin destabilizuar gjithmonë shtetin shqiptar duke furnizuar me mjete monetare eksponentë regresivë për ta bërë të papëlqyeshme sjelljen e tyre përpara Evropës. Sipas Mehdi Frashërit në librin e tij “Kujtime” vetëm në Shqipëri, Greqia kishte 400 priftërinj ortodoksë që të cilët vullnetarisht ishin agjentë lajmërues të mitropolit Jakovit, dhe me anën e këtij ministrit të Greqisë, Baratasit<sup>10</sup>.

9 Teki Selenica për kryengritjen e 1914 do të shprehej. Kjo lëvizje fanatike që po shkurtonte jetën kombëtare burimin e zi e kish: a) n'intrigat sllavo-greke me anën e Esadit e njerëzve të tij.

b) N'intrigat direkte të sllavo-grekëve me anë të dhaskajve, priftërinjve dhe të konsullatave.

c) N'intrigat e turqve të rinj të lindura në vend prej fanatizmsë fetare dhe të përkrahura prej Stambollit e prej Belgradit me anën e Arif Hiqmetit, Qamil Fejzes e Xhenabi Adilit e kompanisë. Shih: Teki Selenica, *Shqipëria më 1937*, f.37

10 M.Fraseri, *Kujtime (vitet 1913-1933)*, OMSCA-1, Tiranë, 2005, f.13

*Ndikimi i turqve të rinj në kryengritjen e Shqipërisë së mesme*

Menjëherë sapo doli në skenë çështja e një princi për Shqipërinë jo vetëm nga Fuqitë e Mëdha por edhe nga dera osmanëve u ofruan kandidatë myslimanë. Midis tyre nga dera e osmanëve ishte Princi Burhanedin i cili u shfaq si kandidatura e vetme në vitin 1914. Ai ishte djali i tretë i sulltan Abdylhamitit. Për të, Shqipëria ishte një vend i bukur, i banuar nga njerëz disi të çuditshëm por besnikë, të cilët ndaheshin në dy kategori; në atë të nepunësve dhe zyrtarëve të perandorisë, dhe në të dytën ato që u ngjanin kopshtarëve, ushtarëve dhe gardës së pallatit<sup>11</sup>.

Një përshkrim të përafërt ka dhënë edhe sulltan Abdyl Hamiti kur e pyetën atë rreth karakterit që ka shqiptari botuar në kujtimet e tija<sup>12</sup>.

Kjo komedi për ardhjen e këtij kandidati, ishte kurdisur nga agjentët e turqve të rinj,<sup>13</sup> për të ruajtur në njëfarë mënyre marrëdhëniet me Perandorinë Osmane<sup>14</sup>. Pasi u zbulua kandidatura e Izet Pashës<sup>15</sup> prej Naseliçi (Maqedonia Jugperëndimore) dhe komploti i Beqir Grebenesë, për t'i dhënë kësaj lëvizjeje një ngjyrë popullore turqit e rinj rekrutuan disa anëtarë të institutit gjuhësor "Aksaray Mahfli" (Katedra e Aksarait). Këta anëtarë të cilët ishin përpjekur për të futur alfabetin osman me shkronja arabe për shkrimin e shqipes, nën drejtimin e Arif Hikmetit ata i nisën për në Shqipëri që të realizonin planin e tyre.

Qysh nga janari i 1914, propaganda në favor të turqve të rinj u bë në të gjitha zonat ku kishte popullsi me shumicë myslimane. Turqit e rinj ishin të interesuar për shqiptarët sepse i llogarisnin ato ende si aleatë të Turqisë. Madje e kishin kuptuar se prej tyre duhej zbatuar politika panislamiste e ndjekur nga Sulltan Abdylhamiti, e cila kishte qenë efikase dhe i kishte bashkuar të gjithë elementet e perandorisë të cilët më parë ishin pjesë e saj.

Turqit e rinj kishin dërguar agjentë të fshehtë, për të nxitur dhe zhvilluar një kryengritje e cila kishte si synim autonominë e Shqipërisë me një princ mysliman në krye. Duke u kapur pas mentalitetit fetar të

11 Eqerem Bej Vlora. "Kujtime (1885-1925)". Shtëpia e librit dhe e Komunikimit, Tiranë 2003. f.354

12 Abdyl Hamiti në një intervistë dhënë një gazetari në lidhje me karakterin e shqiptarit. foli me kujdes: Ai i ndau në dy kategori shqiptarët. Të parët janë primitivë dhe shqiptarë malësorë. Këta bënin hajdutin dhe hynin në shërbimin e më të fortit. Nuk e dinin ç'është dashuria dhe keqardhja. Për këtë arsye këta shqiptarë të paditur, din dhe iman kanë parandë. Ndërsa kategoria e dytë janë punëtorë, të drejtë, me zemër të madhe dhe çdo lloj pune i dalin zot. shih: Zija Karal. *vep e perm.*, f.241

13 Arif Hikmet. Haxhi Adil. Qamil Fejzo, e të tjerë që besonin akoma në idetë propaganduese. fantazitë të turqve të rinj.

14 E.Vlora, *po aty*, f.354

15 Ahmet Izet Pasha, prej familje fisnike të Nasllcit. Përparoi shpejt në karrierë në kohën e Abdylhamitit. Pas shpalljes së konstitucionit (kushtetutës 1908) ai hyri në partinë "Ittihad ve Terakki". Pas dështimit të komplotit të Beqir Grebenesë u dërgua në frontin e Jemenit. Dhe në vitin 1918 u bë kryeministër i Perandorisë Osmane. Gjatë qeverisjes së tij u nënshkrua marrëveshja e Mudrosit. Shih: AQSH. F.56 (Syrja Vlora), D.8, f.80-84, si dhe Eqerem Bej Vlora. "Kujtime (1885-1925)". Shtëpia e librit dhe e komunikimit, Tiranë 2003. f.355

fshatarësisë shqiptare, gjendjen e krijuar në fshat, drejtuesit e saj u bënë premtime demagogjike për ta pasur më të lehtë të formonin bindjen e tyre se duke u ngritur kundër qeverisë së Vidit do të luftonin bejlerët pronarë të tokave dhe pushtetin e tyre. Misioni komplotist i major Beqir Grebenesë dështoi, por pas kësaj u bënë përpjekje të tjera nga turqit e rinj.

Një lëvizje e re e drejtuar nga eksponentë të turqve të rinj si Arif Hikmeti, filloi në 2 maj 1914. Ai kishte nisur të bënte propagandë në Dibër për të proklamuar si mbret të Shqipërisë një princ turk<sup>16</sup>. Propaganda e Arif Hikmetit ishte aq e madhe sa që ai jo vetëm kishte vepruar me fjalë, por edhe me napolona floriri<sup>17</sup>. Themelet e kryengritjes së ardhshme ishin vu aq thellë dhe propaganda ishte e bërë me aq mjeshtëri sa edhe disa intelektualë kujtonin se një lëvizje apo kryengritje e tillë me të vërtetë do të ishte në interes të fesë e të atdheut<sup>18</sup>.

Në 14 maj të po atij viti njoftohet nga konsujt e Austrisë, të cilët e ndiqnin këtë lëvizje hap pas hapi, se Arif Hikmeti së bashku me Esat pashën, po vepronë bashkërisht në një mbulesë<sup>19</sup>.

Kështu gjatë gjithë muajit maj, telegrame të shumta, të cilat do t'i dërgohen Vjenës që e njoftojnë Ballplacin për përgatitjen e kësaj kryengritjeje. Njoftimet jepeshin nga të gjithë konsujt austriakë që ndodheshin në territoret e banuara me shqiptarë. Madje në njërin nga këto telegrame do të tregohet që krahas turqve të rinj edhe Serbia është nxitëse e kryengritjes, nëpërmjet financimit që Qeveria serbe i kishte dërguar Arif Hikmetit për të komanduar një bandë të armatosur prej serbëve<sup>20</sup>.

Njëkohësisht shuma e marrë nga Serbia, do të shërbenin për rekrutimin nga turqit e rinj të myslimanëve prej Resnje, Ohri e Prespe dhe këta i dërgojnë si xhandarë në Dibër prej nga bëhet edhe kalimi i tyre nëpër krahinën e Matit drejt Shqipërisë së Mesme, për të zhvilluar aty një lëvizje revolucionare turke<sup>21</sup>. Mes nxitësve më të mëdhenj të kryengritjes përsëri ishte Arif Hikmeti, i cili fillimisht bashkëpunoi me Beqir Grebenesë e turqit e rinj, dhe më vonë me serbët<sup>22</sup>.

16 AIH, Vj.24-29-2952, Teleg. I Ministrisë së Punëve të Jashtme dërguar M. Pallavaçinit –Stamboll. Vjene, 2.05.1914

17 AIH, Vj. 24-23-2315, Shkup 23 maj 1914, Teleg. I Jeliçkos që informon se këto ditë kaluan me në të postës nga Belgradi 10 mijë napolona ar për Arif Hikmetin në Dibër, ku ai ka për të komanduar një bandë të armatosur prej serbëve.shih: Ismail Strazimiri, *Lufta kundër pavarësisë të Shqipërisë*, (Kujtime Historike), Tiranë 2010. f.46

18 Ismail Strazimiri , po aty, f.47

19 AIH, Vj.24-30-3031, Teleg. Loventalit dërguar M.P.J në Vjenë.

20 AIH, Vj-24-23-2315, Teleg. I Jeliçkos dërguar Ministrisë së Jashtme në Vjenë. Shkup, 23 .05.1914

21 AIH, Vj-24-23-2313, Teleg. I Pleinert dërguar MPJ ne Vjenë, Selanik, 22 maj, 1914 ku thuhet se Esadi dhe Arif Hikmeti janë duke vepruar bashkërisht, Durrës 14 maj 1914.

22 Gorrit T, A.Goslinga, *The Dutch in Albania*, Roma 1972, f.31, cituar sipas Romeo Gurakuqit në "Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë 1913-1914", UET, 2011, f.179

Për veprimtarinë e veçantë të agjentit serb Arif Hikmet, dëshmojnë edhe raportet e konsujve britanikë në Shkup dhe Manastir<sup>23</sup>.

Arif Hikmet konsiderohej nga qarqet diplomatike të kohës si një agjitor i rrezikshëm mbasi zotëronte një dhuratë të rrallë elokuencën e cila i mundësonte atij të lëvizte turmat e fanatikëve në çdo drejtim që ai zgjidhte<sup>24</sup>.

Në radhët e agjitorëve të tjerë që vepruan kundër shtetit shqiptar dhe që manipuluan fshatarët e paditur të Shqipërisë së Mesme, duhet të përmendim agjitorët serbë, grekë deri edhe italianë. Këta u infiltruan në radhët e kryengritësve me synimet e tyre të veçanta politike<sup>25</sup>.

Kështu Musa Qazimi myftiu i Tiranës dhe agjentë të tjerë të turqve të rinj u hodhën në fshatrat e Shqipërisë së Mesme në mënyrë që të tubonin njerëz për të organizuar një kryengritje të brendshme e cila kishte si qëllim që të realizonin planin për ribashkimin e Shqipërisë me Perandorinë Osmane.

Për të ndihmuar këtë lloj propagande Qeveria osmane e unionistëve dërgoi nga Stambolli një grup oficerësh xhonturq, për të organizuar ushtarakisht kryengritjen. Njëkohësisht ata nxorën edhe një organ të tyre turqisht "Sadai Milet" (Zëri i popullit). Redaktorë të këtij organi do të ishin Mehmet Zekiu, Omer Lutfi dhe Musa Juka i njohur si ministër më vonë në qeverinë e Zogut.

Elementët fanatikë të klasës çifligare turkofile të Tiranës të kryesuar nga Musa Qazimi si dhe elementët përsëri proturk të Elbasanit të udhëhequr nga Qamil Haxhi Fejza, nënshkruan në maj të vitit 1914 marrëveshjen e njohur me emrin "Besëlidhja e Krujës" me të cilën shpallën luftën kundër qeverisë së princ Vidit dhe "bashkimin e Shqipërisë me Turqinë"; në rast se kjo do të qe e pamundur ata kërkonin ardhjen e një princi turk nga dera e osmanëve në fronin e Shqipërisë. Sipas tyre princi turk do të ishte Burhanedini, djali i sulltan Abdyl Hamitit të II-të.

23 PRO.FO.371.1894 f.336-337, 246, 247. Raport i zëvendëskonsullit britanik në Shkup Peckam dërguar ambasadorit britanik në Beograd Crackanthorpe, Uscup, May 9, 1914, dhe zëvendës konsullit britanik në Manastir, Greich, drejtuar titullarit të tij në Beograd, Manastir April 21, 1914, Pekam shprehet: "Nga Dibra unë jam informuar se njëtarë Arif Hikmet Beu, që përshkruhet tek unë si në njeri i pamoralshëm dhe i cili paguhet nga Serbia, është duke u përpjekur që t'i nxisë shqiptarët kundër princit të krishterë. Thuhet se ai gjendet në Leshan të rajonit të Dibrës me një suitë prej 300 pasuesish, por kërkon edhe më shumë burra të tjerë dhe si pasojë më shumë para në ar nga Serbia, përpara se të bëjë më shumë vështirësi për Princin". Ndërsa zëvendës konsulli Greich do të shprehej më parë kështu: "...Arif Hikmet, i cili gjatë vitit të shkuar ka luajtur një rol aktiv si një agjent sllav në Shqipërinë e Mesme, ka lënë Manastirin dhe supozohet se do të vizitohet Kostandinopojën dhe Egjiptin. Pak përpara ai udhëtoi në rajonin e Matit, ku besohet se ka bërë agjitacion në të mirë të një kërkesë për një sundimtar mysliman për Shqipërinë. Unë tani mësova se ai kohët e fundit kaloi përmes Manastirit në rrugë për në Dibër ku ai zakonisht bën vizita në rajonet kuftare të Shqipërisë. Kthimi i tij, sipas të gjitha gjasave tregon këmbënguljen e Qeverisë serbe në përpjekjet e veta për të krijuar ndarje në Shqipëri".

24 Pro.Fo.371.1894 f.382, doc.no.23646. Sir Maurice de Bunsen to Sir Eduard Grey, Vienna, may 24, 1914  
25 Romeo Gurakuqi, "Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë 1913-1914", UET, 2011, f.180

Prandaj kryengritësit që në ditët e para të kryengritjes në Shijak dhe Kavajë brohorisnin “Duam babën” dhe kishin ngritur flamurin turk. Kryengritësit drejtoreshin nga përfaqësues të fesë dhe të klerit të ndikuar nga propaganda e turqve të rinj që mendonin se vetëm Turqia mund të ishte shpëtimtari i tyre.

Më 3 qershor 1914, krerët kryengritës organizuan në Shijak një mbledhje të përgjithshme ose një lloj kongresi, ku shpallën programin e tyre. Rolin kryesor e luajtën agjentët e Esat Pashë Toptanit. Kryetar u zgjodh Esatisti Mustafa Ndroqi, nënkryetar u zgjodh ish majori i ushtrisë osmane Xhenabi Adili, anëtarë u bënë myftiu i Tiranës Musa Qazimi, Arif Hikmeti dhe Haxhi Adili. Komandant i përgjithshëm u zgjodh Qamil Haxhi Fejza<sup>26</sup>.

Programi i kryengritësve përmbante këto kërkesa; përmbysjen e Princ Vidit e të qeverisë së tij, bashkimin e Shqipërisë me Perandorinë Osmane, vendosjen e një princi turk në Shqipëri, zëvendësimin e flamurit shqiptar, me gjysmëhënën turke, përdorimin e gjuhës turke dhe zgjedhjen e kryemyftiut nga Shejhul-islami.

Kështu në telegramin e tij Kral, përfaqësuesi i Austrisë pranë KNK-së në Vlorë, shkruan se KNK, ka vendosur t’u drejtohet Fuqive të Mëdha për të bërë protestime në Stamboll lidhur me këtë ngjarje. Gjermania nuk do të pranojë sepse veziri i madh Said Halim Pasha kishte deklaruar se Qeveria turke nuk ka të bëjë aspak me lëvizjen e turqve të rinj në Shqipëri. Këtë qëndrim ajo ua ka bërë të ditur me kohë Fuqive të Mëdha dhe se do të refuzojë kategorikisht çdo shtytje të huaj për të vepruar në Shqipëri<sup>27</sup>.

Duke parë që kjo kryengritje u përhap situata brenda vendit u bë e pakëndshme. Në 4 gusht 1914 filloi Lufta e Parë Botërore, e cila çoi në prishjen e aleancës Austro-Italiane. Prishja e ekuilibrit të interesave ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Italisë në rrafshin ndërkombëtar ishte ndër faktor përcaktues në paqëndrueshmërinë e pushtetit të Vidit në Shqipëri.

Princ Vidi qëndroi asnjahës dhe nuk u bashkua me Austrinë kundër Serbisë, në Luftën e Parë Botërore. Austria duke mos pasur më nevojë për Vidin e likuidoi pushtetin e tij duke i dërguar ultimatum që të largohej nga Shqipëria.

Më 3 shtator 1914, i detyruar nga faktori i brendshëm dhe ai jashtëm, Princ Vidi dhe qeveria e tij u larguan nga Shqipëria duke e lënë pushtetin në duart e KNK-së.

Dhe po më 3 shtator Mustafa Ndroqi i jep një intervistë gazetës italiane “Il Messagero” ku theksonte se “Qëllimi i kësaj kryengritje ka

26 “Kryengritja kundër princ Wiedit”, botuar në “Dokumente historike për t’i shërbyer historisë sonë kombëtare”, Elbasan 1924-1925, f.125

27 AIH, Vj-24-27-2798, Teleg I baronit Mittag, dërguar MPJ në Vjenë, Pera, 1.06.1914

qenë shpallja e osmanllëkut dhe bashkimi me dinastinë osmane” po aty vazhdonte “Flamuri turk është simboli i Këshillit të përgjithshëm”<sup>28</sup>.

Ndërkaq, hyrja e Turqisë në luftë në krah të forcave të Bllokut Qendror aleanca e saj me Austro-Hungarinë, sollën ndryshime në marrëdhëniet e Turqisë me krerët proturq në Shqipëri.

Një nga personazhet politikë të kohës Eshref Frashëri, do t’i shkruante një letër Mithat Frashërit në muajin tetor të atij viti ku do të theksonte ndër të tjera për ardhjen e një delegacioni xhonturk në Shqipëri, për t’i diktuar lëvizjes kryengritëse vijën politike të Perandorisë Osmane<sup>29</sup>.

Ai do të theksonte se kishte filluar një kryengritje fshatare kundër Esat Pashës prej fshatarëve të Shijakut. Tregonte që ishte formuar një Komision në Shkodër i cili kishte filluar bisedimet, për flamurin, për emrin e nëpunësve të rinj duke formuar një komitet të ri dhe pranimin e turqishtes si gjuhë zyrtare<sup>30</sup>.

Udhëzimet nga Stambolli treguan se Qeveria turke kishte pranuar që Shqipëria të shtrihet nën ndikimin Austro-Hungarez. Përpjekjet e marrëveshjet me turqit e rinj bëheshin nga shumë anë.

Kështu Pallaviçini ambasador austriak në Stamboll në telegramin që i drejtonte Bertholdit tregonte se kishte folur me Talat Beun mbi instruksionet që u janë dhënë turqve të rinj në Shkodër<sup>31</sup>. Në fund të janarit Fejzi Bej Alizoti ka hartuar programin e kryengritësve në lidhje me xhonturqit<sup>32</sup>.

Në shkurt të vitit 1915, njoftonin se Fejzi Bej Alizoti dhe Aqif Pashë Biçakçiu qenë marrë vesh tashmë me turqit e rinj në Bari<sup>33</sup>.

Motivet të cilat i shtynë këto patriotë të merren vesh me qarqet sunduese të Perandorisë Osmane ishin të ndryshme. Ata synonin që me anë të ndihmës që do të merrnin nga Qeveria e turqve të rinj, të mund të luftoheshin armiqtë e brendshëm edhe të jashtëm të vendit. Duke justifikuar veprimin e këtyre atdhetarëve, gazeta “Koha” shkruante, se shkaqet e Kryengritjes kundër princ Vidit në Shqipëri nuk mund t’i viheshin vetëm Turqisë e xhonturqve, se ata ishin aleatët e mundshëm dhe prandaj edhe ishin të interesuar për qenien e një Shqipërie të fortë. “Turqia citohesh në këtë gazetë nuk mendon të vijë prapë këtu, -shkruhej në faqet e kësaj gazete –ajo donë që ne të jemi të fortë sepse kemi armiq të përbashkët”<sup>34</sup>.

28 *Historia e Shqipërisë*. Vëll. III, Tiranë, Toena, 2007, f.65

29 AQSh. Fondi nr.35 (Mithat Frashëri), korrespondenca, dosja nr.36 2, dt.8.10.1914 (Letër e Eshref Frashërit nga Shkodra drejtuar Mithat Frashërit )

30 AQSh. Fondi nr.35(Mithat Frashëri) , korrespondenca, dosja nr.36 2, dt.8.10.1914 (Letër e E. Frashërit nga Shkodra drejtuar M.Frashërit )

31 AIH. VJ.25-1-118, Stamboll 7.1. 1915. Raport i amb.a-h.Pallaviçini dërguar ministrit të Jashtëm Berthold.

32 AIH. Vj. 25-4-103 Shkodër 29 janar 1915. Telegr. I kons. Halla në Shkodër drejtuar MPJ në Vjenë.

33 AQSH. F.nr.35 (Mithat Frashëri) . D. Nr.36 4 (Korrespondenca), dok.nr.53442 letër turqisht e datës 15.2.1915.

34 Gazeta “Koha” viti I, nr.4, dt. 11.2.1915, art: “*Turqia dhe Shqipëria*”

Turqia hyri në luftë përkrah me Fuqitë e Boshtit Qendror më 2 nëntor 1914 dhe me atë rast i shpalli luftë edhe Esati Pashë Toptanit si tradhtar. Gjyqi ushtarak otoman e dënon me vdekje.

Në kujtimet e tij, Sejfi Vllamasi thekson se me këtë rast si Turkofilët ashtu edhe xhonturqit u kthyen kundër Esatit, por edhe ai për të thyer rezistencën e tyre arrestoi disa vetë dhe midis tyre Musa Qazimin e të tjerë. Atëherë u krijua një senat i Shqipërisë së Mesme i përbërë nga 29 vetë, nën kryesinë e Mustafa Ndroqit dhe përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha u informuan zyrtarisht për krijimin e tij.

Një delegacion i kryesuar nga Haxhi Aliu, një anëtar i Komitetit të Bashkimit e të Përparimit të turqve të rinj dhe armik i Esat Pashës, kishin krijuar një komision për të shkuar në Stamboll për të kërkuar Burhanedinin të vinte si mbret i Shqipërisë<sup>35</sup>.

Senati i nxitur nga Haxhi Aliu deklaroi përfundimisht që ishte kundër kthimit të Esat Pashës, një deklaratë që u vlerësua në të gjithë Shqipërinë. Ndërkohë edhe Esati vetë nuk ndenji duarkryq. Ai mbështetej tek disa përkrahës të tij vendas, si dhe gëzonte mbështetjen e miqve të tij të jashtëm grekë, serbë, malazezë, veçanërisht atyre Italianë.

Esati në fillim të shtatorit u takua me Pashiqin, duke realizuar një marrëveshje dhe duke u furnizuar bujarisht me fonde dhe pajisje. Ai hyri më 2 tetor në Durrës dhe e detyroi senatin ta shpallte president dhe komandant të përgjithshëm. Mori në dorë pallatin mbretëror dhe shiti pasurinë private të Vedit.<sup>36</sup>

Grushti i shtetit i realizuar nga Esati ngjalli zemërim, prandaj popullsia e Shqipërisë së Mesme kërkoi një shpjegim për rrethanat në të cilat ai kishte gjetur fondet dhe mjetet e tij.

Lidhur me intrigat e tij në dokumentet osmane theksohet se: nga ana e Serbisë iu dërguan Esat Pashës çdo muaj 15 mijë napolona flori, për të mbledhur një forcë prej 5 mijë xhandarë. Ideja ishte të sulmohesh Durrësi dhe Princ Vidi .

Haxhi Qamili, dogji kullën e Esat pashës në çifligun e tij në Laprakë, si dhe shtëpitë e tij në Tiranë. Në sulmet që ai ndërmoi u përkrah edhe nga elementët turkofilë dhe xhonturqit. Esadi u kthye në Durrës dhe të gjitha viset që ndodheshin nën sundimin e tij hynë tashmë nën sundimin e Ehlikijamit ( kryengritjes fshatare).

Hyrja në luftë, kundra Antantës e Perandorisë Osmane si aleate e fuqive të Boshtit Qendror, tregoi që politika e turqve të rinj tashmë ndryshoi. Ajo u bëri thirrje gjithë myslimanëve të botës për luftën e shenjtë

35 Sejfi Vllamasi, "Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)", (Kujtime dhe vlerësime historike), Marin Barleti, Tiranë 1996, f.86 shih: "Memorandumi Përmbi Shqypnië prej Princ Vedit", Tiranë, Arbëria 2008, f.49

36 BOA, DH. EUM.I.1.Şb, Dosya 1, 8/L/ 1332

kundër armiqve të saj dhe si rrjedhim kundër Esat Pashë Toptanit të cilin gjyqi ushtarak otoman e kishte dënuar me vdekje si tradhtarë të Perandorisë Osmane dhe të fesë<sup>37</sup>.

Madje marrëdhëniet u keqësuan me Esad Toptanin kur ai shpërmdau komisionin që u kthye nga Stambolli, nën kryesinë e Haxhi Aliut. Me këtë akt Esat Pasha tregoi se kishte hequr dorë nga marrëveshja e mëparshme për ardhjen e një princi Turk në Shqipëri.

Në fillim të 1915 Perandoria Osmane dërgoi në Shqipëri tri delegacione, të kryesuar nga Hajredin bej Prishtina, Sali bej Jegeni, Fuat bej Pustina dhe Shefqet Peja të cilët iu dhanë udhëzime të reja udhëheqësve të kryengritësve. Ata duhet të shohin jo më drejt Perandorisë Osmane dhe të hiqnin dorë nga politika e krijimit të një principate myslimane në Shqipërinë e mesme, por për të kaluar tashmë në një politikë të re të orientuar drejt Austro-Hungarisë<sup>38</sup>.

Nërkohë vetë aleatja e Perandorisë Osmane, Austro-Hungaria po përpiquej ta pushtonte vetë Shqipërinë dhe ta fuste atë nën suazën e saj.

Perandoria Osmane në këtë kohë do të gjendet në vështirësi të mëdha. Ajo ishte e shtrirë në disa fronte lufte të cilat ishin të papërballueshme si nga ana e forcave të armatosura ashtu edhe nga e furnizimeve ushtarake<sup>39</sup>.

Delegacioni i parë i kryesuar nga Hajredin bej Prishtina dhe Sali bej Jegeni, sillnin me vete edhe një letër nga ministri i Brendshëm i asaj kohe të Perandorisë Osmane, Talat pashës.

Edhe delegacionet e tjera që erdhën mbrapa sollën po të njëjtat udhëzime. Në përputhje me këto udhëzime Fejzi beu së bashku me xhonturqit filloi të hartonin një program të kërkuar nga ana e kryengritësve<sup>40</sup>.

Në këtë program ata do të propagandonin për një Shqipëri më vete, se mund të përdorej flamuri i Shqipërisë në vend të flamurit Turk për të cilin ishte bërë propagandë deri atëherë dhe se mund të pranohej sërish princ Vidi si mbret i Shqipërisë<sup>41</sup>.

Jo të gjithë krerët kryengritës e kuptuan këtë ndryshim dhe grupi udhëheqës i kësaj kryengritjeje u nda në dy grupime; në atë konservatoro-fanatik që vazhdonte të mbante akoma parullat të vjetra, dhe në grupin me përparimtar, që u orientua drejt Austro-Hungarisë.

37 Kristo Frashëri. "Kryengritja e Shqipërisë së Mesme (1914-1915)". Buletini për shkencat shoqërore, nr. 1, 1954, f. 37

38 Sejfi Vllamasi. *Ballafaqime politike në Shqipëri (189"-1942)"*. (Kujtime dhe vlerësime historike), Marin Barleti, Tiranë 1996, f. 87

39 Frontet e luftës janë: Fronti i Kaukazit, i Irakut, i Canakalashë, dhe i vendeve rreth Kanalit të Suezit, sipas historianit Sabahatin Ozel në librin e tij "Turk Inkilap Tarihi". DER yayınlari, seksizinci basım, istanbul, 2001, f.57,59,60,61

40 AIH, Vj.25-4-483. Shkodër 9 janar 1915. Teleg. I konsullit Halla në Shkodër dërguar, MPJ në Vjenë.

41 Memorandum për mbi Shqypninë prej Wilhelmit. Mbret i Shqypnias princ Wied. (Përgatiti për botim Hasan Bello), Arbëria 2008, f.52

“Aso kohe,- thekson në kujtimet e tij Ismail Strazimiri, kishin ardhë në Dibër disa fetva prej Stambolli. Me këto fetva thirrreshin myslimanët me marrë pjesë në luftë kundra armiqve të Turqisë myslimane”<sup>42</sup>.

Përkundrejt interesave të përbashkëta shumë vetë shfaqnin edhe mosbesimin e tyre të thellë, të përforcuar nga e kaluara e afërt, ndaj politikanëve xhonturq<sup>43</sup>. Aleancën me xhonturqit e shikonin me dyshim dhe partizanët e shumtë të ruajtjes së asnjansimitit së shtetit të ri shqiptar<sup>44</sup>.

Në të vërtetë komiteti xhonturk i Stambollit në marrëveshje me Vjenën dhe nën shtytjen e saj përpigjej t’i lidhte shqiptarët pas vetes dhe t’i fuste në luftë kundër Serbisë për llogari të vet<sup>45</sup>.

Mendimi se shpëtimi i Shqipërisë do të varej nga suksesi që do të kishte aleanca austro-gjermane i çonte shumë politikanë shqiptarë të asaj kohe drejt afrimit me Turqinë, me qarqet sunduese të saj, me turqit e rinj dhe me përkrahësit e tyre në Shqipëri.

Aleanca e tyre me ata duhet parë jo vetëm në gjykimin dhe simpatinë e disa elementëve vendas të kësaj kryengritjeje, por edhe në koniunkturat e jashtme. Ata ofruan shqiptarin Kara Said Pashën, i cili pritej të vinte në Shkodër<sup>46</sup>.

Kara Said Pasha një komandant i ushtrisë turke në pension i ardhur nga Stambolli për në Gjenevë dhe i përkrahur nga Austria për të shpëtuar Shqipërinë më 4 tetor 1916 u zu rob nga malazezët duke kaluar për në Shqipëri<sup>47</sup>.

Në dhjetor të 1914, Italia pushton Vlorën, pushtimi i saj ndiqet me vëmendje edhe nga Perandoria Osmane.

Në disa dokumente të cilat gjenden në arkivin osmane në letërkëmbimet e kryeministrit të Perandorisë Osmane në këtë kohë, Said Halim Pashës me ambasadorin e tij në Itali, flitet rreth lëvizjeve të cilat kishin lidhje me Shqipërinë. Madje në këto telegrame të dërguar nga ambasadorët e Portës së Lartë në Romë dhe Berlin thuhej se Italia po përgatitet të pushtojë Vlorën dhe Shqipërinë<sup>48</sup>.

42 Ismail Strazimiri, *Lufta kundër pavarësisë të Shqipërisë, Kujtime historike*, Naimi, Tiranë, 2010, f.71

43 Gazeta “*Dielli*”, V.VI, nr.388, dt.8.1.1915, Opinga, “Kryengritja kundër Esatit”.

44 Gazeta “*Dielli*”, v. Vi, nr.306, dt.1.2.1915, P Kordha , “Korrespondencë nga Shkodra” ( 29 dhjetor 1914): Ç’sillet në Shqipërinë e Mesme, fanatikë dhe xhonturq”.

45 AIH. HHStA, PA, A.Rap.sekret nr.2 i Pallavacinit drejtuar Bertholdit , Stamboll 7.1.1915. Në financimin e ketij aksioni ambasadori austriak në Stamboll, Pallavicini qe treguar mjaft i pakursyer . Në krye të tij ai kishte vënë Fuad Beun të nipin e Fuat Pash’ës (Prishtinës)

46 Lidhur me këtë problem Pandeli cale i shkruante Themistokli Gërmenjti në Bukuresht se më çfarë do të nisej në Shkodër Vasili (mbiemri nuk i dihet ), për të mos shkruar të gjithë bashkë dhe shprehte besimin se me ta do të nisej edhe Kara Said Pasha. AQSH, F.847,D.nr.5, Dok nr.V/135, Lozanë, dt.16.1.1915.

47 BOA, HR. SYS. D.2427, 4 tetor 1916

48 BOA, DH. EUM.1.Sb.14.7 16 zilhicce/332 ose 23 Tesrini-evvel/330

Në fund të dhjetorit agjentët xhonturq së bashku me përkrahësit e tyre i dërguan një telegram princit Vid me të cilin e njoftonin se e njihnin atë si mbret të Shqipërisë<sup>49</sup>.

Në shkurt të vitit 1915, përsëri me nxitjen e xhonturqve disa nga krerët e Këshillit të përgjithshëm në një mbledhje të veçantë që bënë në Elbasan me nxitjen e një delegacioni nga Stambolli aprovuan një rezolutë të cilën ia drejtuan Princ Vidit, që ndodhej atëherë në frontin e Karpateve si major i ushtrisë gjermane. Në këtë rezolutë thuhej se kryengritësit dëshironin kthimin e tij në Shqipëri<sup>50</sup>.

Lëvizja kryengritëse e Shqipërisë së Mesme u përjetua me dhimbje dhe me një ndejnë revolte nga atdhetarët shqiptarë. Në shkrimet e tyre të botuar në organet e shtypit brenda e jashtë vendit, ata dënuan rolin tradhtarë të Esat pashë Toptanit në këtë kryengritje, si dhe të udhëheqësve fanatikë e antikombëtarë të saj<sup>51</sup>.

Gazeta "Dielli" do të shkruante se: "kjo lëvizje ishte e ushqyer prej Turqisë e ndihmuar prej Serbo-Greqisë dhe e përhapur prej Italisë. Ajo u rrit nga pakujdesia e qeverisë, shumica e së cilës mbahet vetëm me këto propaganda dhe është e kompromentuar me kryengritësit"<sup>52</sup>.

49 *Memorandum përmbi Shqypënië*. Prej Wilhelmit, mbret i Shqypënisë Princ Wied. (Përgatiti për botim Hasan Bello). Arbëria 2008. f.53

50 Joseph Swire. *Shqipëria ngritja e një mbretërie*. Dituria 2005. f.200

51 *Historia e Popullit Shqiptarë*, vëll.III. Botimet Toena, Tiranë 2007. f.72

52 Gjendja e Shqiperise, Dielli, dt.24.7.1914; shih S.Vllamasi. *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*. (Kujtime dhe vlerësime historike). Marin Barleti, Tiranë 1996. f.86

**Ma. Ilirjana KACELI**

**SUMMARY**

**THE UPRISING IN CENTRAL ALBANIA AND THE  
ROLE OF YOUNG TURKS**

Following Prince Wied's arrival in Albania on 7 March 1914, an Albanian government was formed which headed by Turhan Pashe Përmeti, and Esat Pasha was appointed for the interior minister. The Wied administration was not preferred by Albanians from the beginning as its main governmental advisers were not Albanian citizens.

As a consensual prince chosen with the agreement, he would gather around him advisors, nationals of the Powers who engaged into a race of influence to the prince.

Wied government would develop in two currents, pro-Italian and pro-Austrian, with all members of the cabinet aligned in two camps. On 10 April 1914 was stipulated Organic Statute of Albania, namely the Constitution. The challenge for Prince Wied's governance was to maintain the borders determined by the Ambassadors Conference of London.

Wilhelm Wied during his government has been faced with difficulties due to the poor judgment of the country's complex situation. His power found support only outside by the Great Powers, and their actual presence through KNK members.